

PROVINCA AUTONOME E BOLZANOS  
ALTO ADIGE  
INSTITUTI I PËRGJITHSHËM  
NË GJUHËN ITALIANE  
RRUGA MONTESSORI 3  
39055 LAIVES  
TEL: 0471/ 954423  
FAX:0471/ 953502

Për të gjithë nxënësit dhe nxënëset  
e shkollës fillore "M. Gandhi"  
Për të gjithë prindërit  
e shkollës fillore "M. Gandhi "

## **TITULLI: komunikim nga Drejtoria e Shkollës në lidhje me mësimëdhënien në distancë 14 prill 2020**

Të dashur nxënës, nxënëse dhe prindër,

Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen e rëndësishme në plotësimin e pyetësorit, lidhur me zhvillimin e mësimëdhënies në distancë, rezultatet e së cilës do të ndahen me ju menjëherë pasi ato të përpunohen përfundimisht.

Falenderoj të gjithë mësuesit, nxënësit, dhe familjet e tyre për punën e shkëlqyer që po bëjnë në këtë situatë të vështirë: bashkëpunimi shkollë-familje është i domosdoshëm më shumë se kurrë në këto momentë. Unë ju kërkoj të jeni të durueshëm nëse diçka nuk është e përsosur dhe për t'ju bërë ju sa më aktiv me sugjerime, drejtohuni drejtpërdrejt tek mësuesi kujdestar i klasës. Është një situatë e re për të gjithë, në të cilën ne po punojmë shumë dhe jemi duke bërë çmos për të siguruar funksionimin e plotë.

Kam zgjedhur të ndaj me ju udhëzimin e Ministrisë së Arsimit me numër protokolli 388, datë 17 Mars 2020 i cili thotë:

"Është e vërtetë që veprimtaritë e mësimëdhënies në distancë duhet të zhvillohen, sepse në të kundërt do të dështonte arsyeja sociale e vetë shkollës, siç është e përcaktuar në kushtetutë, është po aq e nevojshme që të kryhen veprimtaritë e vlerësimit të vazhdueshëm, sipas parimeve të afatit dhe transparencës, të cilat, në përputhje me legjislacionin aktual, por edhe me standartet e mësimëdhënies, ku mësuesi duhet të informojnë çdo vlerësim për secilën veprimtari mësimore. Nëse nxënësi nuk informohet menjëherë çfarë ka gabuar, pse ka gabuar dhe ku ka gabuar, vlerësimi shndërrohet në një ritual sanksionues, i cili e humbet lidhjen me mësimin, pavarësisht nga forma në të cilën ushtrohet. Vlerësimi gjithashtu është një tregues i rëndësishëm për përmirësimin dhe vazhdimësinë e marrjes së njohurive, rikuperimin e tyre, konsolidimin, kërkimin, me qëllim motivimin e nxënësve dhe studentëve, aq më tepër në një situatë si kjo në të cilën ndodhemi aktualisht. Është kompetencë dhe detyrë e mësuesit për të vlerësuar në bazë të profilit profesional si dhe e drejta e studentit, për të marrë vlerësimin si një element i domosdoshëm i verifikimit të veprimtarisë së kryer, të kthimit, të sqarimit, të identifikimit të ndonjë boshllëku, brënda kriterëve të përcaktuara nga secila autonomi e shkollës, por që sigurojnë fleksibilitetin e nevojshëm.(...).Pasqyrimi mbi procesin e trajnimit të realizuar gjatë periudhës aktuale të pezullimit të veprimtarisë mësimore në frekuentimin do të ndahet si zakonisht nga Këshilli i mësuesve. “

Na kërkohet përpjekje dhe angazhim i mëtijshëm, dhe ne ende besojmë në mbështetjen dhe bashkëpunim tuaj të domosdoshëm: materiali do të përqendrohet në 4/5 lënde mësimore dhe do të dërgohet një herë në javë nga mësuesi/ja kujdestar i/e klasës, në mënyrë që familjet të organizohen siç duhet.

Duke marrë parasysh rezultatet e pyetësorit në lidhje me mësimëdhënien në distancë, ne do të marrim përsipër dhe do të aktivizohemi sa më shumë me veprimtari mësimore me video, leksione on-line, mësimë interaktive në internet, falë përdorimit të platformave; mësuesit do të zgjedhin një platformë për klasën e tyre, në mënyrë që të mos ngatërrohen.

Do të jenë të privileguara lëndët mësimore që kanë numrin e orëve javore më të madh ( gjuhë italiane, matematikë, gjuhë gjermane, gjuhë angleze) gjithashtu janë të parashikuara dhe do të shpërndahen në mënyrë të drejtë edhe veprimtarit mësimore për lëndët e tjera.

Do të drejtoheni nga mësuesit mundësisht nëpërmjet kanaleve që nuk kërkojnë regjistrim nga nxënësit apo familjet e tyre. Në veçanti, për gjuhën gjermane dhe gjuhën angleze do të programojmë veprimtari mësimore nëpërmjet video, leksione interaktive duke favorizuar sa më shumë që të jetë e mundur dëgjimin dhe të folurin.

Gjatë vazhdimit të pezullimit të veprimtarive mësimore në përputhje me legjislacionin aktual, mësuesve u kërkohet të caktojnë detyrat duke parashikuar kthimin e tyre për të siguruar vlerësimin i cili do të vendoset tek regjistri elektronik.

Kriteret e vlerësimit janë miratuar nga stafi mësimëdhënës dhe do të përshtaten me

programimin mësimor në distancë duke patur parasysh, fleksibilitetin, natyrën e jashtëzakonshme të

situatës, që si qëllim kanë angazhimin dhe pjesëmarrjen e të GJITHË fëmijëve, duke u kujdesur për nevojat e individualizuara dhe të personalizuara të trajnimit të secilit nxënës.

Rikujtoj se, veprimtarit mësimore në distancë janë të detyrueshme, si dhe kthimi i detyrave dhe vlerësimi i tyre.

Shpresoj të jeni mirë të gjithë. Falenderoj dhe uroj nxënësit për mënyrën se si po e përballojnë këtë situatë.

Drejtoresha e shkollës  
Prof. Germana Fiore